



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**UDHËZIM**

**METODOLOGJIK**

**“MBI MBIKËQYRJEN E GRUPIT TË SIGURIMIT”**

*Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 250, datë 28.12.2018*

Në bazë të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe të neneve 140-148, të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit për Bashkëpunimin Reciprok dhe Shkëmbimin e Informacionit në Fushën e Mbikëqyrjes së Sigurimeve me Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve Maqedoni dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për Bashkëpunim dhe Shkëmbim Informacioni me Bankën Qendrore të Kosovës (BQK) Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare:

**UDHËZON:**

**1. Objekti dhe fusha e zbatimit**

Objekti i këtij udhëzimi metodologjik është vendosja e rregullave të përgjithshme dhe një sistemi bashkëpunimi midis institucioneve mbikëqyrëse, si Kolegj Mbikëqyrës të Grupit të Sigurimit, me qëllim shkëmbimin e informacionit në funksion të mbikëqyrjes efektive në nivel grupi për shoqëritë vendase të sigurimit dhe risigurimit, të cilat kanë investime apo degë të tyre në vende të huaja.

**2. Raportimi**

- a. Mbikëqyrja e grupit të sigurimit do të realizohet nëpërmjet raportimit dhe shkëmbimit të informacionit brenda Kolegjit Mbikëqyrës të Grupit të Sigurimit.

- b. Raportimi kryhet nëpërmjet formës së përcaktuar nga Autoriteti. Forma e raportimit krijohet për shkëmbim informacioni dhe për procesin e vlerësimit të rrezikut të subjekteve të mbikëqyrura.

### 3. Forma e raportimit

Raportimi pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare kryhet sipas formatit të paraqitur në Aneksin 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe përmban:

- a. Përmbajtja.
  - i. Forma përmban informacion për të gjithë subjektet e mbikëqyrur nga autoritetet mbikëqyrëse, pjesë e kolegjit, brenda juridiksionit të tyre. Informacioni i ofruar do t'u shpërndahet të gjithë pjesëmarrësve të Kolegjit të Grupit të Sigurimit. Shifrat raportohen në euro.
  - ii. Informacion lidhur me Autoritetin që plotëson formën, kontaktet dhe periudhën e raportimit si dhe grupin e sigurimit.
- b. Të dhënat kryesore mbi shoqërinë e mbikëqyrur.
  - i. Të dhënat kryesore të aktivitetit të Jetës dhe të Jo-Jetës si: Primet e shkruara bruto, total i aktiveve, provigjonet teknike, rezultati teknik, rezultati neto, kthimi mbi investimet, % e primeve të shkruara bruto ndaj MTPL, raporti i shpenzimeve, raporti i kombinuar.
  - ii. Treguesit kryesorë të aktivitetit të Jetës dhe të Jo-Jetës, si aftësia paguese (mjaftueshmëria e kapitalit) dhe aktivet në mbulim të provigjoneve teknike.
- c. Çështje në lidhje me raportimin në Autoritet.
  - i. Vlerësimi i cilësisë së Raportit të Auditimit të Jashtëm, në një shkallë nga 1 deri në 4, ku 1 do të thotë cilësi shumë të mirë dhe 4 do të thotë cilësi e ulët.
  - ii. Kualifikimet dhe çështjet kryesore lidhur me raportet e auditimit të pavarur.
- d. Sistemi qeverisës.
  - i. Vlerësimi i cilësisë së qeverisjes së shoqërisë, menaxhimit të rrezikut, auditit të brendshëm në një shkallë prej 1 deri në 4, ku 1 do të thotë cilësi shumë të mirë dhe 4 do të thotë cilësi e ulët.
  - ii. Çështjet kryesore lidhur me qeverisjen e shoqërisë, ndryshimet në organet drejtuese të shoqërisë.

- e. Aktivitetet mbikëqyrëse.
  - i. Inspektimet në terren të vitit aktual dhe atij të fundit, si dhe inspektimet e planifikuara në vend. Paraqitjen e gjetjeve kryesore të inspektimeve të listuara më lartë në vend.
  - ii. Vendimet e Bordit që janë aktualisht në fuqi për shoqërinë e sigurimit.
  - iii. Informacion që lidhet me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
  
- f. Vlerësimi i rrezikut.
  - i. Sipas klasifikimit të rreziqeve si: Rrezik Makroekonomik, Rrezik Ligjor, Rrezik Investimi, Rreziku i Portofolit të Sigurimit, Rrezik i Qeverisjes, si dhe Çdo Rrezik tjetër.  
(Plotësohet nga shoqëria dhe jepet një përshkrim i shkurtër i rrezikut të deklaruar duke dhënë vitin kur është identifikuar së pari rreziku).

#### **4. Përmbajtja e Formës**

- a. Forma e raportimit i dërgohet nëpërmjet e-mail-it të posaçëm të gjithë autoriteteve, të cilat mbikëqyrin shoqëritë që janë subjekt mbikëqyrje në nivel grupi. Forma plotësohet sipas udhëzimeve dhe dërgohet në AMF brenda afateve të kërkuara në komunikim. Shoqëria e kontrolluar në një grup sigurimi i raporton Autoritetit në baza 3-mujore “formën e raportimit” brenda 2 javëve që nga përfundimi i tremujorit paraardhës. Shkëmbimi i informacionit do të kryhet me baza 3-mujore sipas raportimeve të shoqërive të sigurimit.
  
- b. Kolegji do të mbledhet 4 herë në vit sipas periudhave:
  - i. Mbledhja e parë brenda javës së parë të marsit të çdo viti.
  - ii. Mbledhja e dytë brenda javës së parë të qershorit të çdo viti.
  - iii. Mbledhja e tretë brenda javës së parë të shtatorit të çdo viti.
  - iv. Mbledhja e katërt brenda javës së parë të dhjetorit të çdo viti.
  
- c. Autoritetet pjesëmarrëse në kolegji mund të kërkojnë edhe mbledhje të jashtëzakonshme, pasi të jetë specifikuar urgjenca e çështjes. Në rast se kërkohet vendimmarrje nga autoritetet pjesëmarrëse në kolegji, informacioni lidhur me çështjen objekt vendimi shkëmbetet paraprakisht së bashku me arsyet për të cilat kërkohet vendimmarrja.
  
- d. Vendimet e organit drejtues të autoriteteve pjesëmarrëse në kolegji lidhur me Grupin e Sigurimit duhet t’u vihen në dispozicion të gjitha autoriteteve pjesë e Kolegjit Mbikëqyrës të Grupit të Sigurimit.

- e. Autoritetet në çdo rast vendimmarrje, që ka impakt edhe në shoqëritë e tjera të një grupi sigurimi, duhet të shkëmbejnë informacion paraprak me Autoritetin ku ndodhet shoqëria që impaktohet nga kjo vendimmarrje.

## **5. Inspektimet e përbashkëta**

- a. Autoritetet pjesë e kolegjit mbikëqyrës mund të bien dakord për organizimin e inspektimeve të përbashkëta të shoqërive të sigurimit, pjesë të grupit të sigurimit, të rregulluara nën juridiksionin e palës pritëse. Kërkesa ose ftesa për inspektime të përbashkëta duhet të përmbajë:
  - i. Shoqërinë që do të inspektohet;
  - ii. Objektin dhe programin e detajuar të inspektimit, periudhën e inspektimit;
  - iii. Kohëzgjatjen e inspektimit;
  - iv. Përcaktim të personave pjesë e grupit të inspektimit.
- b. Format e raportuara mund të jenë subjekt rishikimi gjatë inspektimeve të përbashkëta midis autoriteteve, në bazë të nevojave për shkëmbimin e informacionit.
- c. Shkëmbimi i informacionit midis palëve do të bëhet nëpërmjet shkresave zyrtare, ose postës elektronike në adresat e palëve, gjuha që do të përdoret nga autoritetet pjesëmarrëse në kolegje është gjuha angleze.

## **6. Konfidencialiteti**

- a. Informacioni i shkëmbyer brenda Kolegjit Mbikëqyrës i nënshtrohet parimit të ruajtjes së konfidencialitetit dhe nuk përdoret për qëllime të tjera me përjashtim të objektit të këtij udhëzimi.
- b. Palët do ta përdorin informacionin e marrë vetëm për qëllim të ushtrimit të funksioneve mbikëqyrëse. Çdo informacion i marrë nga autoritetet e huaja jashtë Kolegjit Mbikëqyrës, nuk mund të ndahet brenda Kolegjit Mbikëqyrës pa pëlqimin paraprak, me shkrim, të autoritetit të huaj i cili e ka dhënë informacionin.
- c. Autoritetet mbikëqyrëse brenda Kolegjit Mbikëqyrës marrin përsipër të gjitha përgjegjësit për ruajtjen e konfidencialitetit brenda kompetencave të parashikuara nga kuadri ligjor në fuqi.

## **7. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.**